



KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

01 Nr 351-14844/23
Date 04.05.2023

KONTRATË NR. 040-2023

Numri i kontratës¹: 634-23-3521-2-2-1/C586

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
Kolegji Ndërkombëtar Për Biznes Dhe Teknologji - UBT, Prishtinë, Lagja Kalabria, 810514853, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mbeshtetja e komunes ne pergaditje e PZHK-es per vitet 2023-2031 me numër identifikues: 634-23-3521-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Mbeshteje profesionale ne Hartimin e Planit Zhvillimor lokal per vitet 2023-2031,, Mbeshtetje e komunes ne pergaditje te PZHK per vitet 2023-2031 sipas njesis kerkuse

No.	Lot
1	Mbeshtetja e komunes ne pergaditje e PZHK-es per vitet 2023-2031

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 27,376.00 €; [njëzet e shate mije e treqind e shtadhjet e gjashte Euro.

2.2 Plani dinaik eshte 6 muaj kalendarik

2.3 sigurimi i ekzekutimit do te jete 6+1 muaj = 7 muaj

2.4 Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 2,737.00 EUR.

2.5 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.6 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.1 termat e references

TERMAT E REFERENCES PËR PLANI ZHVILLIMOR TË KLINËS

Në bazë të Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-174 - PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR dhe kërkesave për përmbajtjen e Planit Zhvillimor Komunal të përfshira në Udhëzimin Administrativ UA Nr. 11/2015 - MBI ELEMENTET DHE KERKESAT THEMELORE PER HARTIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL, Kuvendi Komunal ka marre vendimin me 01Nr.06-21104/21 të dt.01.07.2021 për fillimin e procesit të përpilimit të planit zhvillimor të Komunës dhe I njëjti ka marrë shqyrtimin e ligjshmerisë nga MAPLme Nr.020-615/5 të dt.22.07.2021

Plani Zhvillimor Komunal duhet të hartohet në bazë parimeve të përcaktuara me UA Nr. 11/2015

I. Parimet e përgjithshme

1. Parimet e shënuara në këtë nen i plotësojnë parimet e listuara në Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe janë të vlefshme për tërë Planin Zhvillimor Komunal:

1.1. Parimi demokratik: promovimi i qeverisjes së mirë transparencës, nëpërmjet gjithëpërfshirjes llogaridhënies dhe sundimit të ligjit;

1.2. Parimi i subsidiaritetit: njohja e vendimeve, kornizave ligjore, planeve dhe politikave të nxitura nga kërkesat lokale. Parimi i subsidiaritetit e njeh nevojën që disa vendime të bëhen në nivel qendror nëse kërkohet nga shkalla apo rëndësia e çështjes;

1.3. Parimi i pjesëmarrjes: forcimi i legjitimitetit të politikave dhe procesit të vendim-marrjes duke krijuar ndjenjën e pronësisë lokale për të siguruar që të drejtat e komunitetit dhe ato pronësore do të merren parasysh;

1.4. Parimi i përfshirjes: përfshirja e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm në proceset e planifikimit zhvillimor si dhe në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave;

1.5. Parimi i proporcionalitetit: hartimi i politikave të qarta që e mbrojnë mjedisin, tokën bujqësore, pyjet dhe burimet ujore, biodiversitetin, monumentet dhe lokacionet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, që inkurajojnë zhvillim social dhe ekonomik dhe që stimulojnë inovacionet; dhe

1.6. Parimi parandalues: parandalimi i veprimeve apo politikave të cilat kanë mundësi ta degradojnë mjedisin, edhe nëse nuk ka dëshmi shkencore për ndikimin e tyre në mjedis.

2. Të gjitha pjesët e Planit Zhvillimor Komunal të jenë në harmoni me njëra tjetrën, dhe të gjitha pjesët të jenë në harmoni me hartën e shfrytëzimit të planifikuar të tokës dhe të gjitha planet zhvillimore sektoriale.

3. Plani Zhvillimor Komunal duhet të jetë konkret, për të krijuar bazën mbi të cilën do të hartohet Harta Zonale e Komunës.

4. Parimet e mësipërme të respektohen gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të PZHK-së.

5. Autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor sigurohet që janë respektuar parimet gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të PZHK-së.

II. Forma e prezantimit

1. Plani Zhvillimor Komunal përbëhet nga pjesët tekstuale dhe hartografike të cilat prezantohen në mënyrë digjitale dhe në format të shtypur për miratim dhe nënshkrim formal. PZHK-ja mund të përmbajë informata tjera grafike, tabelare dhe fotografike.

2. Pjesa tekstuale e PZHK-së përmban këto pjesë:

- 2.1. Hyrjen;
- 2.2. Profilin e Komunës;
- 2.3. Vlerësimi i Gjendjes;
- 2.4. Korniza e Zhvillimit Hapësinor; dhe
- 2.5. Prioritetet Strategjike Zhvillimore dhe Plani i Veprimit.
3. Pjesa hartografike e PZHK-së përmban harta hapësinore konceptuale dhe harta të planeve zhvillimore sektoriale siç detajohet në nenin 11.
4. Teksti i PZHK- së duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Pjesët tekstuale prezantohen në format A4.
6. Format, përmbajtja dhe përpjesa e paraqitjes e të gjitha të dhënave dhe pjesësve hartografike përcaktohet me Udhëzimin Administrativ për Data bazën e Planifikimit Hapësinor.
7. Të gjitha hartat hapësinore konceptuale, hartat ilustrative dhe hartat e planeve zhvillimore sektoriale prezantohen mbi harta të gjeo- referencuara ortografike dhe topografike.
8. Të gjitha të dhënat bazë dhe të dhënat në GIS bëhen pronë e komunës.

III. Pjesa hartografike

1. Pjesa Hartografike e PZHK së përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike për tërë hapësirën e komunës të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në një platformë GIS, i cili paraqet informacione thelbësore për të gjitha planet zhvillimore sektoriale si rrjedhojë Konceptit të Zhvillimit e Hapësinor dhe Prioriteteve Strategjike të Zhvillimit. Këto harta përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në të mëposhtmet:
 - 1.1. Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar paraqet të gjitha vendbanimet egzistuese dhe të planifikuara me hapësirat për ndërtim dhe masat e mbrojtjes për zhvillim;
 - 1.2. Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës përcakton shfrytëzimin e ardhshëm të tokës për bujqësi, banim, komercijale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim i përzier;
 - 1.3. Hartat e planeve zhvillimore sektoriale përfshirë hapësirat, ndërtimet dhe infrastrukturën e planifikuar me të gjitha instalimet mbitorësore dhe nëntokësore, si më poshtë:
 - 1.3.1. Harta e Planit të Zhvillimit Ekonomik;
 - 1.3.2. Harta e Planit Infrastrukturës së Transportit;
 - 1.3.3. Harta e Planit të Transportit urban dhe rural;
 - 1.3.4. Harta e Planit të Energjisë Elektrike dhe Termike;
 - 1.3.5. Harta e Planit të Ujësjetllësit dhe Kanalizimit;
 - 1.3.6. Harta e Sistemit të Ujitjes dhe të drenazhimit;
 - 1.3.7. Harta e Planit të Telekomunikacionit dhe Instalimeve të Ngjajshme;
 - 1.3.8. Harta e Planit të Hapësirave Publike dhe Sociale;
 - 1.3.9. Harta e Planit të Hapësirave Sportive;
 - 1.3.10. Harta e Planit të Hapësirave të Hapura Publike dhe të Gjellbra;
 - 1.3.11. Harta e Planit të Menaxhimit të Varrezave; dhe

1.3.12. Harta e Planit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore.

1.3.13. Harta e Planit për Mbrojtjen nga Rreziqet Natyrore; dhe

1.3.14. Harta e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Riciklim

ZBATIMI DHE MONITORIMI

1. Dispozitat për Zbatim udhëheqin arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal

Korniza e aktiviteteve

Periudha optimale e përfundimit të Plani Zhvillimor Komunal është afërsisht 32 javë. Kontraktori do të jep një plan dinamik të aktiviteteve duke specifikuar involvimin e stafit kompetent në detyrat specifike të punës gjatë secilës fazë të projektit.

Qasja në të dhënat e komunës

Komuna do të sigurojë qasje në të gjitha informatat relevante ekzistuese: plane, harta, strategji, hulumtime, dokumente ligjore etj të cilat tashmë janë nxjerrë nga Komuna ose janë hartuar për Komunën nga institucione të tjera.

Takimet publike

Aktivitetet e mësipërme të listuara do të bëhen në konsultim me Komunën dhe përmes takimeve konsultative me qytetarë. Pas përfundimit të draftit të planit, ai duhet të vihet në dispozicion publikut për shqyrtim publik sipas rregullave të përcaktuara me ligjin për planifikim hapësinor.

Transferimi i njohurive

Konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Komunës me qëllim për t'i bërë ata të marrin pjesë në procesin e planifikimit, konceptet themelore dhe metodat e hulumtimit të përfshira në procesin e planifikimit.

Në përfundim, konsulenti do të përgatisë një program mbi ngritjen dhe trajnimin e kapaciteteve të stafit komunal në sistemin informativ GIS.

Konfidencialiteti

Dokumentet dhe të dhënat që do të vihen në dispozicion të kompanisë nga Autoriteti i Planifikimit Vendor, duhet të konsiderohen konfidenciale dhe nuk duhet të transmetohet tek palët e treta.

PROCESI

Duke e konsideruar se planifikimi si proces është më i rëndësishëm se plani si produkt, Komuna do të përqendrohet në organizmin e procesit dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve relevant për marrjen e vendimeve në mënyrë demokratike dhe transparente për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kualitetit të të gjithë qytetarëve të Komunës.

Në bashkëpunim me kontraktorin, Komuna do të përkujdeset të zbatojë në tërësi parimet e gjithpërfshirjes përmes informimit, prezantimeve dhe konsultimeve me qytetarë për çështjet e rëndësishme për zhvillimin e komunës.

Gjatë procesit të hartimit të planit, duhet të përcaktojë grupin e aktorët kyç i cili së bashku Komunën dhe hartuesin, do të përcaktojë kornizat e planit dhe marrin vendimet që bazohen në propozimet e hartuesit.

Gjatë procesit duhet të organizohen takimet për konsultime dhe prezantimin e gjendjes ekzistuese dhe propozimeve të cilat duhet të marrin parasysh interesat e qytetarëve duke mos e cenuar interesin publik të zhvillimit të Komunës.

Neni 4

Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) **Sigurimi** i ekzekutimit
- (g) *Vendimi për menaxhim të projektit*
- (h) *Plani dinamik*
- (i) Metodologjia

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5

Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues Komuna Kline

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	04.05.2023
Vula:	



Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	EDMOND HASPIRI
Pozita:	<i>[Signature]</i>
Nënshkrimi:	PRESIDENT
Data:	04.05.2023
Vula:	

Mbeshtetja e komunes ne pergaditje e PZHK-es per vitet 2023-2031

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi	Norma e TVSH-së	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali	Totali (me TVSh)	Totali TVSh	Titulli prodhues
1	Mbeshtetja ekomunes ne pergaditjen te PZHK per vitet 2023-2031	23,200.00	18.00	27,376.00	1.00	total	23,200.00	27,376.00	4,176.00	KK Klinë